



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:222810

Datë: 10.01.2025

Numri i dokumentit: 06695014

KPPP.nr. 1244/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Florent Zeqiri, në çështjen përbarimore të kreditorit Kompania “Pro & Co Group” Sh.P.K., me numër unik identifikues 811092254 dhe seli në Graçanicë, Llapllasellë, rr. “Marigona Residence”, p.n., të cilin sipas autorizimit e përfaqësojnë Taulant Ferizi dhe Arlind Fetahu, avokat nga Prishtina, kundër debitorit Kompania “Premiera Residence” Sh.P.K., me numër unik identifikues 811395319 dhe seli në Lipjan, rr. “Sadik Shala”, nr. 146, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve “SCLR Partners” Sh.P.K., me seli në Prishtinë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përbarimor P.nr. 201/24 të datës 23.07.2024, të lejuar nga Përbaruesi Privat Irfan I Kërçagu, me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datën 10.01.2025, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit Kompania “Premiera Residence” Sh.P.K., ashtu që Urdhri përbarimor P.nr. 201/24 i datës 23.07.2024, i lejuar nga Përbaruesi Privat Irfan I Kërçagu, ANULOHET.
- II. DETYROHET kreditori që në emër të shpenzimeve për përpilimin e prapësimit, t’ia paguajë debitorit shumën prej EUR 208.00 (*dyqind e tetë euro*), në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi.

A r s y e t i m

Përbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Kompania “Pro & Co Group” Sh.P.K., ka caktuar urdhrin P.nr. 201/24 të datës 23.07.2024, duke lejuar përbarimin në bazë të dokumenteve të besueshme: Faturës nr. 007-B-02/2023 e datës 28.02.2023; Faturës nr. 009-

B-03/2023 e datës 06.03.2023; Faturës nr. 016-B-04/2023 e datës 14.04.2023; Faturës nr. 020-B-04/2023 e datës 28.04.2023, si dhe Faturës nr. 026-B-04/2023 e datës 12.05.2023, me të cilin e ka urdhëruar debitorin "Premiera Residence" Sh.P.K., që në afat prej shtatë (7) ditësh pas pranimit të urdhrit t'ia paguajë kreditorit borxhin në shumë prej 76,813.50 EUR, me kamatë ligjore prej 8 %, nga dita e rënies në vonesë e deri në pagesën përfundimtare, si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore dhe shpenzimet për përpilimin e propozimit për përmbarim në shumë prej 208.00 EUR.

Debitori, përmes përfaqësuesit të autorizuar ka prapësuar urdhrin përmbarimor duke theksuar se faturat mbi bazën e të cilave është lejuar përmbarimi nuk i plotësojnë kushtet për përmbarim sipas dispozitave të LPP-së meqenëse nuk janë të pranuar nga debitori. Më tej ka theksuar se kreditori, në shkresat e lëndës ka bashkangjitur një marrëveshje tri paleshe për shumën e kërkuar si në propozimin për përmbarim, me anë të së cilës marrëveshje kreditori dhe debitori janë pajtuar që vlera prej 76,813.50 EUR të bartet tek subjekti tjetër me emrin "Beta Group". Ndërsa, sa i përket pretendimit se faturat janë dërguar me postë, nga dëshmitë e bashkangjitura shihet se në zarfin e dërguar nuk ka ndonjë shënim se kemi të bëjmë me fatura, e aq me pak kur për shkak se nuk ka pasur ndonjë shënim për përmbajtjen debitori nuk ka pranuar të njëjtat. I ka propozuar gjykatës që prapësimi i debitorit të aprovohet, ndërsa urdhri përmbarimor të anulohet, si dhe të obligohet kreditori që të kompensojë shpenzimet për përpilimin e prapësimin në shumë prej 208.00 EUR.

Kreditori, në përgjigjen në prapësimin e ka kundërshtuar prapësimin e debitorit si të pabazuar duke theksuar se asnjë nga kundërshtimet e debitorit nuk përmbajnë shkaqet e prapësimin të cilat parashihen me nenin 71 të LPP-së. Më tej, ka theksuar se i gjithë argumentimi i debitorit në prapësim është që zarfi i cili ka arritur me fatura nuk ka pasur shënime për ndonjë faturë, mirëpo zarfat në asnjë rast nuk përmbajnë shënime ku thuhet se në brendësinë e tij ka fatura. Ka shtuar se debitori ka qenë i njoftuar me përmbajtjen e faturave dhe obligimin që kishte ndaj kreditorit, ku vërtetohet përmes marrëveshjes së pajtimit të datës 05.04.2024, ku ndër të tjera janë pajtuar që vlera e obligimit të Beta Group Sh.P.K., ndaj Pro & Co Sh.P.K., do të jetë 378,647.50 EUR, ashtu që duke qenë se kompania Beta Group Sh.P.K., asnjëherë nuk ka përmbushur obligimet ndaj kreditorit, atëherë edhe debitori Primera Residence mbetet e obliguar që të paguante faturat e pa përmbushura, pasi që debitori dhe Beta Group Sh.P.K., janë në pronësi të pronarëve të njëjtë. Për këto arsye, i ka propozuar gjykatës që të refuzojë prapësimin e debitorit si të pa bazuar,

ndërsa urdhri përmbartimor të mbetet në fuqi, si dhe të obligohet debitori që të paguajë për përpilimin e përgjigjes në prapësim në shumë prej 208.00 EUR.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim, shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbartimor duhet të anulohet për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*, kurse me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*.

Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat gjeti dokumentet e besueshme: Fatura nr. 007-B-02/2023 e datës 28.02.2023, Fatura nr. 009-B-03/2023 e datës 06.03.2023, Fatura nr. 016-B-04/2023 e datës 14.04.2023, Fatura nr. 020-B-04/2023 e datës 28.04.2023 si dhe Fatura nr. 026-B-04/2023 e datës 12.05.2023 mbi bazën e së cilave është lejuar përmbartimi ndaj debitorit, nuk i plotësojnë kushtet për të qenë të përshtatshme për përmbartim ngase nuk mund të vërtetohet që të njëjtat janë dorëzuar në mënyrë të rregullt nga ana e kreditorit dhe se janë pranuar nga debitori, duke qenë se në faturat e lartcekura mungon nënshkrimi apo vula e pranimit të debitorit.

Gjykata vlerësoi Marrëveshjen trepalëshe të datës 05.04.2024 të nënshkruar në mes debitorit “Premiera Residence” Sh.P.K., kreditorit “Pro & Co Group” Sh.P.K., si dhe subjektit “Beta Group” Sh.P.K., në të cilën marrëveshje konstatohet se palët janë pajtuar që pas nënshkrimit të saj, obligimi i debitorit “Premiera Residence” Sh.P.K. ndaj kreditorit në vlerë prej 76,813.50 EUR, (shumë kjo identike me shumën e kërkuar përmes përmbartimit), të bartet te subjekti “Beta Group” Sh.P.K., por që pikërisht nga kjo marrëveshje, rezulton se kemi të bëjmë me kalim të debisë dhe marrje përsipër e borxhit nga debitori tek subjekti Beta Group Sh.P.K.

Në këtë drejtim, përkundër faktit se debitori “Premiera Residence” Sh.P.K., formalisht evidentohet si debitor në dokumentet e besueshme, i njëjti nuk vihet në detyrim sipas faturave

objekt i këtij përmbarimi kjo meqenëse marrja përsipër e borxhit nga personi i tretë, dhe atë me pëlqimin e kreditorit, e liron debitorin nga shlyerja e detyrimeve, rrethanë kjo që përcaktohet me nenin 432 të Ligjit nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve me të cilin përcaktohet se *“Me marrjen përsipër të borxhit, marrësi vihet në vendin e debitorit të mëparshëm, ndërsa ky lirohet nga detyrimi”*.

Përkundër kësaj, kreditori nuk ka pengesë që përmbarimin e faturave objekt i këtij përmbarimi ta realizoj direkt ndaj subjektit i cili ka marrë përsipër borxhin, edhe pse i njëjti nuk evidentohet si debitor në dokumentin e besueshëm, kjo në mbështetje të nenit 31 par. 2 të LPP-së i cili përcakton se *“Përmbarimi caktohet edhe kundër personit të tretë i cili në dokumentin përmbarimor nuk përmendet si debitor, po qe se kreditori me anë të dokumentit publik apo privat, por të vërtetuar sipas ligjit provon se personi i tillë në mënyrë të ligjshme e ka marrë përsipër borxhin (debinë) nga dokumenti përmbarues, apo se ai borxhin e tillë sipas ligjit është i detyruar ta shlyejë. Po qe se kontestohet detyrimi i personit të tretë për marrjen përsipër të borxhit, atëherë palët para se të lejohet përmbarimi, kontestin duhet ta zgjidhin në procedurë kontestimore”*.

Nga të lartcekurat, gjykata gjen se prapësimi i debitorit gjen mbështetje në nenin 71 par.1, nënpar. 1.6 të LPP-së me të cilin përcaktohet që *“kreditori nuk është i autorizuar të kërkojë përmbarimin në bazë të dokumentit përmbarues, gjegjësisht ai nuk është i autorizuar të kërkojë përmbarimin kundër debitorit”*, andaj dhe u vendos si në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Pretendimi i kreditorit se pronar i vetëm sikurse i debitorit ashtu edhe i marrësit përsipër të borxhit është personi i njëjtë Besnik Dërmaku nuk ndikon në vendosjen ndryshe në këtë çështje përmbarimore, kjo për faktin se debitori “Premiera Residencë” Sh.P.K., dhe marrësi i borxhit “Beta Group” Sh.P.K., janë të organizuar në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, dhe si të tilla janë vetvetiu bartëse e te drejtave dhe obligimeve në raport me palët e treta.

Gjykata po ashtu pati parasysh faktin se kreditori ka tentuar që faturat objekt i këtij përmbarimi t’i dorëzoj tek debitori përmes dërgesës postare por që nga vet fletë kthesa e Postës së Kosovës e datës 08.07.2024, në pjesën e pasme të saj, evidentohet mbishkrimi *“refuzohet nga marrësi”*, andaj kjo formë e dorëzimit nuk mund të konsiderohet e rregullt për gjykatën përderisa debitori ka shprehur kundërshtim të pranimit të faturave, e rrjedhimisht edhe kundërshtim të detyrimeve që derivojnë nga to.

Lidhur me shpenzimet e procedurës përbarimore gjykata vendosi në kuptim të dispozitave të nenit 463 të LPK-së, lidhur me nenin 13 dhe 17 të LPP-së, duke i'a njohur shpenzimet përfaqësuesit të debitorit në emër të prapësimit të ushtruar në shumë prej EUR 208.00, konform rregullores në fuqi për tarifat e avokatëve.

Nga të lartcekurat, e në kuptim të nenit 71 par. 1.1 dhe 73 të LPP-së, si dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 1244/24, datë 10.01.2025

Gjyqtari

Florent Zeqiri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.